

Republika e Shqiperise
Enti Rregullator i Sektorit te Energjise Elektrike

LICENSE
PER VEPRIMTARINE
E FURNIZIMIN PUBLIK ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Seria: _____

Numri i Licenses: _____

Data e hyrjes ne fuqi: _____

(Vendim i ERE-s, Nr. _____, date ____ . ____ . ____)

Licensa i jepet: _____

(Emri dhe adresa)

Kodi fiskal: _____

Certifikata e Regjistrimit: _____

(Seria, Numri, Vendi i Regjistrimit)

Me autoritetin qe i eshte dhene sipas Pjeses se Trete te Ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 “Per Sektorin e Energjise Elektrike”, te ndryshuar, Enti Rregullator i Sektorit te Energjise Elektrike (“ERE”) ja jep kete License te furnizimit publik me shumice te energjise elektirke per kryerjen e veprimtarise se furnizimit publik me shumice te energjise elektrike me tarifa te rregulluara personit fizik/juridik te lart-permendur, i quajtur “I Licensuari”, subjekt i Kushteve te Licenses bashkangjitur kesaj License. Kjo License hyn ne fuqi ne daten e mesiperme dhe do te vazhdoje te mbetet ne fuqi per nje periudhe 5 vjeçare, deri sa te perfundohet nga i licensuari apo te hiqet nga ERE ne perputhje me kushtet e Licenses te perfshira ketu dhe legjislacionit ne fuqi.

[Kryetari]

[Vula e ERE-s]

KUSHTET E LICENSES

Per

FURNIZIMIN PUBLIK ME SHUMICË ME ENERGJI ELEKTRIKE

Seria: _____ Nr. i Licensës. _____

I jepet: _____

(Emri i plotë i të Licensuarit)

1. Dispozita të Përgjithshme

1.1 ERE është autoriteti i vetëm në Republikën e Shqipërisë, i njohur sipas Pjesës së Tretë të ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, që lëshon dhe deklaron hyrjen në fuqi të kësaj Licence.

1.2 Nëse ndonjë kusht i kësaj License pushon së qeni efektiv, ai kusht do të hiqet nga Kushtet e Licensës dhe Kushtet e mbetura të Licensës do të vazhdojnë të jene në fuqi.

1.3 Kjo Licensë, nuk do t’i transferohet tërësisht ose pjesërisht, asnjë Personi tjetër pa miratimin paraprak me shkrim të ERE-s. Kur miraton një transferim, ERE mund ta modifikojë periudhën e licensës ose kushtet e tjera të Licensës pasi të ketë treguar një arsye të bazuar.

1.4 ERE ndryshon Licensen në përputhje me nenin 19 i Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike, si dhe në rastet e mëposhteme,

a. nevoja për garantimin e mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare si dhe të rendit publik pas marrjes në konsideratë të pozicionit të autoriteteve shtetërore kompetente;

b. nevoja për të garantuar qëndrueshmërinë dhe furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të klientëve;

c. rreziku për jetën e qytetarëve ose për dëmtimin e shëndetit të tyre, si dhe dëmtimi i mjedisit ose dëmtimi i pasurisë së palëve të treta, kur rreziku nuk kërkon heqjen e Licensës;

d. në licensë është bërë një gabim i qartë faktik; ose

e. një ndryshim në kuadrin ligjor lidhur me tregun e energjisë elektrike përfshirë ndryshimet në kuadrin ligjor ose rregullat e zbatueshme për të Licensuarin që rrit materialisht koston e sigurimit të nivelit të shërbimit të kërkuar sipas kësaj License pa masa për shlyerjen e këtyre kostove nga i Licensuari.

1.5 I Licensuari mund të kërkojë një modifikim të kësaj License nëpërmjet një kërkesë të detajuar me shkrim që domosdoshmërisht duhet të përmbajë një justifikim për modifikimin e kërkuar. Një kërkesë e tillë mund të miratohet vetëm nëse i Licensuari tregon se modifikimi nuk do të çojë në ulje të çmimit, ose në rritje të çmimit dhe

tarifave per klientet apo perdoruesit e te Licensuarit. Ne cdo rast ERE do te kryej nje procedure modifikimi sipas nenit 19 te Ligjit nr.9072 date 22.05.2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike".

1.6. I Licencuari mund t'i parashtojë ERE-s një kërkesë me shkrim për rinovimin e Licensës jo më pak se 6 muaj para përfundimit të afatit së Licensës se dhene. Afati i të Licensuarit do të zgjatet kur Bordi i Komisionereve te ERE-s, bazuar në ligjin përkatës dhe në prova të besueshme, konkludon se:

I Licensuari i ka përmbushur kushtet e Licensës dhe i është përmbajtur kërkesave të te gjithë legjislacionit ne fuqi gjate afatit te licenses.

1.7 Në rast se Bordi i Komisionereve refuzon ta zgjasë afatin e Licensës, deri në përfundim të saj, i Licensuari:

- i. nese jepet miratimi nga ERE, mund t'ia transferoje pronesine mbi asetet qe perdor per kryerjen e veprimtarise se Licensuar nje pale te trete - blesesit. Asetet do te transferohen vetem teresisht, pervecse kur ERE, sipas ligjit nr. 9072, date 22.05.2003 "Per Sektorin e Energjise Elektrike" te ndryshuar, percakton ndryshe; ose
- ii. nese jepet miratimi nga ERE, ja transferon operimin e veprimtarise/faciliteteve te Licensuar nje subjekti qe ne gjykimin e ERE-s mund te ushtroje veprimtarine e Licensuar nga ERE.
- iii. Ne rast se i Licensuari nuk e transferon pronesine e aseteteve para dates se perfundimit te Licenses fillestare dhe revokimi i Licenses mund te rezultoje me rrezik per mbrojtjen kombetare dhe sigurine, rendin publik dhe furnizimin e panderprere te klienteve me energji elektrike, ERE-ja me iniciativen e vet mund te caktojë nje subjekt per kryerjen e funksioneve te te Licensuarit, qe mund te jene te nevojshme per performancen e panderprere te ketyre funksioneve.

1.8 Pervecse kur ndryshon kuadri ligjor, për Shqipërinë do të jepet vetëm një licencë për Furnizimin Publik me Shumice me energji elektrike, por mund të jepen gjithashtu licenca për furnizimin me energji elektrike nga Furnizues të Kualifikuar për Klientët e Kualifikuar të lokalizuar brenda Shqipërisë.

1.9 Fjalët dhe frazat e mëposhtme të përdorura në Licencë, në Kushtet e Licensës dhe në Shtojca, do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

Shërbimet Ndihmëse	Gjithë shërbimet e nevojshme për operimin e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes.
Biznesi Shoqerues	Çdo biznes që direkt ose indirekt, tërësisht ose pjesërisht: 1. zotërohet nga i Licencuari; ose 2. zotëron të Licencuarin; ose 3. zotërohet nga një Person që zotërohet nga i Licencuari.

Ligjit Nr.9072	Do të thote ky ligj me te gjitha ndryshimet e ndodhura apo qe mund te ndodhin ne te ardhmen e qe ne vijim do te perdoret shkurtimisht me emertimin Ligji per Energjine.
Date 22.05.2003“Për Sektorin e Energjisë Elektrike”	
Energjia Elektrike	Energjia elektrike dhe kapaciteti elektrik, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe.
Klient Tarifor	Një person që blen energji elektrike nga Furnizuesi Publik me Pakicë me tarifa të miratuara nga ERE. Të gjithë personat që blejnë energji elektrike që nuk janë Klientë të Kualifikuar janë Klientë Tariforë..
Klienti i Kualifikuar	Një klient që ka të drejtën, sipas legjislacionit në fuqi ose rregulloreve të të ERE-s, të zgjedhë furnizuesin e energjisë elektrike të përdorur për nevojat e tij.
Legjislacioni në Fuqi	Ligjet e Republikës së Shqipërisë të shpallura nga Kuvendi Shqiptar dhe që janë në fuqi gjatë periudhës së kësaj licence dhe cdo akt nenligjor i nxjerr ne zbatim te ligjit. .
Licensë e Furnizuesit Publik me Shumicë te Energjise Elektrike	Eshte autorizimi qe i jepet nje personi siaps percaktimeve te Pjeses se Trete te Ligjit Nr.9072, date 22.05.2003”Per Sektorin e Energjise Elektrike” te ndryshuar
Veprimtaria e Licensuar	Veprimtari të nevojshme dhe direkt të lidhura me blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike me shumicë me qëllimin e furnizimit të Klientëve Tariforë dhe plotësimit të detyrimeve të “Siguruesit të Alternativës së Fundit” me Tarifa të Rregulluara.
I Licensuari	Personi që mban këtë Licencë te Furnizuesit Publik me Shumicë te Energjise Elektrike .
Personi	Person do të thotë çdo person fizik ose juridik
Furnizuesi i Kualifikuar (FK)	Një Person që ka të drejtën të furnizojë me energji elektrike Klientët e Kualifikuar siç përcaktohet nga Legjislacioni në Fuqi dhe Rregullat e ERE-s.
Tarifa e Rregulluar	Një tarifë aktualisht në fuqi dhe e miratuar nga ERE sipas Legjislacionit në Fuqi dhe Rregullave të ERE-s.
Rregulloret dhe Rregullat	Standardet, kodet, rregulloret, urdhrat dhe rekomandime të tjera ligjërish në fuqi të miratuara nga ERE.
Prodhuesi i Vogël i Energjisë Elektrike	Prodhues i energjisë elektrike nga një central i lidhur me Rrjetin e Shpërndarjes.
Transferimi	Transferim do të thotë çdo shitje, dhënie me qira ose ndonjë zgjidhje tjetër, tërësisht ose pjesërisht, i së drejtës për t'u angazhuar në Veprimtarinë e Licencuar.

Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST)	Personi i licencuar përgjegjës për veprimtaritë e transmetimit dhe dispeçerimit dhe procesin e kontrollit të operimit të impianteve gjeneruese dhe faciliteteve të tjera të industrisë së energjisë dhe burimeve për sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemit, sigurisë, operimit të sigurt dhe eficient të sistemit elektroenergjetik.
Operatori i rrjetit	Strukture e Operatorit të Sistemit të Shperndarjes e cila kryen veprime të planifikuara ose jo në Sistemin e Shperndarjes duke marrë në konsideratë programimin dhe ruajtjen e sigurisë operative si dhe parametrave të cilësive sipas kushteve teknike.

2. Kryerja e Veprimtarisë së Licencuar

- 2.1 I Licensuari autorizohet nga kjo License për kryerjen e Veprimtarisë së Licencuar në Republikën e Shqipërisë. Kjo e drejtë i jepet ekskluzivisht të Licensuarit.
- 2.2 I Licensuari nuk do të bashkëpunojë në asnjë mënyrë me të licensuar të tjerë për përgatitjen dhe negocimin me ERE-n të çështjeve që lidhen ose ndikojnë mbi tarifën e energjisë elektrike ose pagesat e tjera që zbatohen për klientët, përveç kur lejohet shprehimisht nga Legjislacioni në Fuqi, ose të bëjë marrëveshje në ndonjë mënyrë tjetër lidhur me Veprimtarinë e Licencuar në dëm të furnizuesve ose klientëve ekzistues ose të mundshëm.
- 2.3 I Licensuari do t'i ndajë llogaritë e veta financiare sipas veprimtarive të prodhimit dhe furnizimit, brenda periudhës kohore të kërkuar nga Legjislacioni në Fuqi në mënyrë që t'i mundësojë ERE-s të konkludojë se nuk po ndodhin ndërshtetë, veprimtari anti-konkurrese apo diskriminuese përveç kur lejohet në mënyrë specifike nga ERE.
- 2.4 I Licensuari nuk do të angazhohet në asnjë formë monopoli ose ndonjë veprimtari tjetër anti-konkurrese të ndaluar nga Legjislacioni në Fuqi.
- 2.5 I Licensuari do ta kryejë Veprimtarinë e Licencuar në përputhje me parimet e eficientë ekonomike dhe objektivin e arritjes së kostos më të ulët me standarde të përcaktuara të cilësisë dhe performancës.
- 2.6 I Licensuari nuk do të angazhohet në aktivitete të tjera, që pengojnë ose mund të pengojnë kryerjen si duhet të Veprimtarisë së Licencuar. I Licensuari do të njoftojë ERE-n para se të ndërmerret ndonjë veprimtari, përveç Veprimtarisë së Licencuar. ERE-ja mund ta ndalojë të Licensuarin të kryejë ndonjë veprimtari, përveç Veprimtarisë së Licencuar, ose mund të vendosë kushte për kryerjen e kësaj veprimtarie, siç është e nevojshme për mbrojtjen e klientëve.
- 2.7 I Licensuari do të informojë ERE-n për ngritjen e çdo Biznesi Shoqëruar. ERE-ja mund ta ndalojë ose të vendosë kushte për ngritjen e Biznesit Shoqëruar, siç është e nevojshme për mbrojtjen e klientëve të Republikës së Shqipërisë.
- 2.8 I Licensuari nuk do të pengojë, parandalojë ose të përpiqet të parandalojë të licensuar të tjerë apo konkurrese potencialë nga angazhimi i ligjshëm ose hyrja në biznesin elektrik në Republikën e Shqipërisë.

3. Detyrimet e të Licensuarit

- 3.1 I Licensuari do të respektojë Legjislacionin në Fuqi, gjatë ushtrimit të funksioneve sipas kësaj license.

3.2 Llogaritë dhe Raportimi

3.2.1. I Licensuari do të mbajë regjistra llogarie dhe do të përgatisë pasqyra financiare, që do të mbahen më vete për Veprimtarinë e Licensuar dhe çdo veprimtari tjetër (përfshirë veprimtari të tjera të licensuara) ku është angazhuar i Licensuari, sipas rregullave financiare dhe procedurave të miratuara nga ERE dhe sipas ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" i ndryshuar, neneve 21, 23 dhe 33 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", te ndryshuar, dhe parimeve ndërkombëtare financiare. I Licensuari do t'i paraqesë ERE-s raportin financiar vjetor në 30 qershor të çdo viti.

3.2.2. Të Licensuarit i kërkohet të përgatisë dhe t'i paraqesë ERE-s në 31 Janar të çdo viti, një raport vjetor lidhur me operimet e tij gjatë vitit të mëparshëm kalendarik, që përmban sa më poshtë:

- a) përmbledhjen dhe analizën e veprimtarisë furnizuese të të Licensuarit;
- b) shitjet e energjisë elektrike dhe të dhënat mbi mbledhjen e faturave për vitin;
- c) mjaftueshmërinë e furnizimit, përfshirë çdo reduktim ngarkese, dhe detajet e çdo mase të marrë për përmirësimin e kostos dhe mjaftueshmërisë së furnizimit;
- d) çdo ndërprerje të furnizimit;
- e) gjithë kontratat e furnizimit; dhe
- f) një tabelë që tregon performancën e Furnizuesit Publik me Shumicë sipas Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Shpërndarjes në atë shkallë që zbatohen.

3.2.3 I Licensuari do t'i paraqesë ERE-s, me kërkesën e saj dhe sipas formës dhe brenda kohës së vendosur nga ERE, çdo informacion që është i domosdoshëm për ERE-n për të kryer përgjegjësitë e saj rregullatore të autorizuara.

3.2.4 I Licensuari do t'i ndajë shpenzimet e përbashkëta mes Veprimtarive të tij të Licensuara dhe tipave të tjera të veprimtarive (përfshirë veprimtaritë e licensuara) mbi baza të arsyeshme, në përputhje me paragrafin 3.2.1 të kësaj License dhe praktikat përgjithësisht të pranuar të biznesit. I Licensuari do t'i paraqesë ERE-s, dokumentacionin që përcakton bazat për ndarjen e shpenzimeve të përbashkëta si dhe rezultatet e arritura.

3.2.5 I Licensuari do ta njoftojë ERE-n brenda 10 ditëve për çdo ndryshim të:

- a) Adresës;
- b) Statutit të të Licensuarit;
- c) Certifikatës së regjistrimit;
- d) Kodit fiskal;
- e) Drejtuesve të lartë; ose
- f) Aksioneve deri në 5%.

3.2.6 Gjithë njoftimet zyrtare, aplikimet, peticionet dhe pretendimet lidhur me këtë Licensë duhet të jenë me shkrim, të ekzekutohen në kohën e duhur nga një zyrtar i autorizuar ose një përfaqësues i zgjedhur i të Licensuarit ose ERE-s, përkatësisht, dhe të shpërndahen me korrier ose me postë të regjistruar, duke kërkuar verifikimin e marrjes. Adresat e Palëve duhet të duken mbi zarf. Të gjitha njoftimet ose korrespondenca tjetër do të konsiderohen se hyjnë në fuqi nga momenti i shpërndarjes ose, nëse nuk janë shpërndarë për shkak të gabimit të dërguesit, nga momenti i paraqitjes.

3.3 Përdorimi i Informacionit

3.3.1 Sipas Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike, Kodit të Rrjetit, Kodit të Shpërndarjes, Rregullave të Tregut dhe kërkesave përkatëse të rregullimit, i Licensuari do të sigurojë që çdo informacion i marrë nga të tjerët si rezultat i Veprimtarisë së tij të Licensuar nuk do t'i zbulohet askujt, përveç:

- a) me pëlqimin paraprak me shkrim të Personit me çështjet e të cilit lidhet informacioni;
- b) kur informacioni është tashmë i njohur për publikun;
- c) kur të Licensuarit i kërkohet ose i lejohet ta përhapë informacionin për të përmbushur Kushtet e kësaj License, çdo urdhër të ERE-s, ose çdo Legjislacion të zbatueshëm në Fuqi.

3.3.2 I Licensuari do të sigurojë që asnjë Biznes Shoqërues nuk do ta përdorë informacionin në pronësi të të Licencuarit për të fituar përparësi konkurruese të pajustificuar dhe do të sigurojë se nuk do të përhapë asnjë informacion tek ndonjë Person tjetër (përfshirë ata të një Biznesi tjetër Shoqërues) që mund ta mundësojë këtë Person të arrijë çdo lloj përparësie komerciale të pajustificuar.

3.3.3 I Licensuari do të hartojë dhe do t'i paraqesë ERE-s procedura që sigurojnë respektimin e Paragrafëve 3.3.1 dhe 3.3.2. Me kërkesën e ERE-s, i Licensuari do të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm për ta mbrojtur informacionin konfidencial që posedon i Licensuari dhe do t'i paraqesë ERE-s raporte që lidhen me respektimin e detyrimeve të parashikuara në Paragrafët 3.3.1 dhe 3.3.2.

3.3.4 Informacioni që i sigurohet ERE-s nga i Licensuari do të konsiderohet publik përveç, kur me kërkesë të veçantë të të Licencuarit, ERE me vendim siguron se ky informacion është i natyrës pasurore dhe se interesi publik të cilit i shërbehet nga përhapja e tij nuk do ta justifikojë ose kompensojë dëmin komercial potencial ndaj të Licencuarit.

3.3.5 ERE mund t'i kërkojë të Licencuarit të publikojë informacionin mbi veprimtarinë e tij, përfshirë informacionin e raportuar sipas seksionit 3.2.2 më lart, subjekt i kufizimeve të përcaktuara sipas 3.3.4 më lart.

3.4 Detyrimet Dypalëshe

3.4.1 I Licensuari do të blejë furnizim të mjaftueshëm me energji elektrike për të përmbushur gjithë nevojat e klientëve tariforë dhe nevojat e vendosura mbi të Licencuarin me kapacitetin e Siguruesit të Alternativës së Fundit. I Licensuari do të njoftojë ERE-n dhe OST-në sa herë që nuk është në gjendje të sigurojë furnizim të mjaftueshëm, dhe do të përshkruajë me detaje gjithë përpjekjet që ka ndërmarrë i Licensuari për të siguruar furnizim të mjaftueshëm në çdo rast kur furnizimi është i pamjaftueshëm për të plotësuar ngarkesën. Nëse kostoja e furnizimit e të Licencuarit është shumë e madhe, siç përcaktohet më parë nga i Licensuari me miratimin e ERE-s, i Licensuari mund të refuzojë ta blejë këtë furnizim edhe nëse furnizimi agregat është i pamjaftueshëm për të plotësuar ngarkesën e klientëve tariforë. I Licensuari ka të drejtën dhe detyrimin të hyjë në marrëveshje dypalëshe me KESH-Gjenerimin dhe çdo furnizues tjetër për të siguruar furnizim të mjaftueshëm sa herë që është e mundur me koston më të ulët të mundshme. Çmimi i furnizimit që merr i Licensuari nga KESH-Gjenerimi do të jetë me tarifa të miratuara nga ERE. I Licensuari mund të hyjë në kontrata dypalëshe furnizimi me Tregtarët sipas një procesi konkurrues prokurimi, subjekt i rishikimit nga ERE për të përcaktuar nëse i Licensuari ka vepruar në mënyrë të kujdesshme. Përmbushja

e seksionit 3.5, më poshtë, do të konsiderohet si provë e mjaftueshme që i Licensuari ka vepruar në mënyrë të kujdesshme.

3.4.2 ERE mund të kërkojë që i Licensuari të demonstrojë se ka siguruar kapacitet gjenerues të mjaftueshëm për të plotësuar furnizimin e tij të planifikuar, subjekt i kufizimeve të vendosura mbi të Licensuarin lidhur me marrëveshjet dypalëshe me çmime që konsiderohen shumë të larta nga ERE. Nëse një detyrim i tillë vendoset mbi një të Licensuar, ERE do të specifikojë vëllimin e kapacitetit të gjenerimit që duhet siguruar.

3.5 Për sigurimin e furnizimit me energji elektrike, i Licensuari do të veprojë në përputhje me rregullat që qeverisin prokurimin e energjisë elektrike të vendosura në Ligjin për “Prokurimin Publik”.

3.6 I Licensuari në përputhje me Rregullat e Tregut do të ndërmarrë gjithë masat e nevojshme për përmirësimin e eficiencës ekonomike të Veprimtarisë së Licensuar me qëllim që të sigurojë qëndrueshmërinë e furnizimit dhe çmime të arsyeshme.

3.7 I Licensuari do të përmbushë Rregulloret dhe Rregullat e zbatueshme të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të miratuara nga ERE, përfshirë zbatimin e gjithë urdhërave operativë, udhëzimeve ose orientimeve dhe paraqitjen e informacionit teknik dhe gjithë dokumentacionit tjetër të kërkuar sipas kërkesave të Kodit të Rrjetit dhe Rregullave të Tregut.

3.8 Pagesat e Rregullimit

1. Licensuari do të paguajë rregullisht dhe në mënyrë të vazhdueshme pagesat e rregullimit gjatë kohëzgjatjes së kësaj License siç përcaktohet nga ERE, sipas Nenit 12 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe rregulloreve të ERE-s.

2. Nëse i Licensuari nuk i paguan ERE-s pagesat e rregullimit sipas paragrafit 3.8.1 brenda periudhës së kërkuar nga ERE, i Licensuari do të penalizohet sipas Nenit 64 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

3.9 Tarifa e Furnizimit Publik

Pagesa totale e Furnizuesit Publik me Pakicë për Furnizimin Publik me Shumicë do të përcaktohet sipas Metodologjisë së Tarifave për Furnizimin Publik me Shumicë të miratuar nga ERE. Tarifa do të caktohet për t’i siguruar të Licensuarit të ardhura të mjaftueshme për të mbuluar nivelet e arsyeshme të kostove dhe fitimeve, dhe nxitës për reduktimin e kostove dhe për të operuar në mënyrë eficiente.

I Licensuari mund të propozojë, subjekt i miratimit të ERE-s, metoda tarifash për të siguruar që ndryshimet në koston e furnizimit, përfshirë ndryshimet e krijuara nga ndryshimet në kushtet hidrologjike brenda sistemit KESH-Gjen, nuk i reduktojnë fitimet ose fluksin e parave nën nivelet e konsideruara nga ERE si të arsyeshme.

4. Monitorimi dhe Kontrollat mbi Performancën e Veprimtarisë të Licensuar

4.1 ERE do të monitorojë respektimin nga i Licensuari të Kushteve të Licensës, do të shqyrtojë raportet e marra nga i Licensuari dhe, është e autorizuar që të inspektojë në çdo kohë regjistrat financiare të të Licensuarit dhe mund të kërkojë një auditim teknik

dhe/ose financiar të veprimtarive të të Licensuarit.

- 4.2 Përfaqësuesit e autorizuar të ERE-s mund të hyjnë në ambientet, pajisjet dhe dokumentet e të Licensuarit për të inspektuar Veprimtarinë e Licensuar sipas Rregullave të ERE-s. I Licensuari do të japë çdo ndihmë të kërkuar nga ERE gjatë këtij inspektimi.
- 4.3 Në bazë të ankesës së konfirmuar të çdo pale të tretë ose me vetë iniciativën e vet, ERE mund të nisë një hetim mbi përmbushjen nga i Licensuari të Kushteve të Licensës ose Rregullave të ERE-s.
- 4.4 Nëse pas hetimit, ERE konkludon se i Licensuari nuk i ka përmbushur Kushtet e Licensës, ERE mund t'i rishikojë tarifat e të Licensuarit dhe / ose të ndërmarrë veprime të tjera brenda synimit të autoritetit të saj me qëllim që të mbrojë interesat e klientëve të energjisë elektrike ose të sigurojë përmbushjen e afateve dhe kushteve të kësaj license.
- 4.5 I Licensuari do ta informojë ERE-n për çdo shmangie të Kushteve të Licensës, një javë pasi kjo shmangie i bëhet e njohur të Licensuarit.
- 4.6 I Licensuari do të zbatojë vendimeve të nxjerra nga ERE, përfshirë pagesat e gjobave të vëna nga ERE, sipas Legjislacionit në Fuqi, .

5. Matja e energjise

I Licensuari do të sigurojë që e gjithë energjia e blerë dhe e shitur nga i Licensuari të matet si duhet.

6. Heqja e Licensës

- 6.1 ERE mund ta heq Licensën sipas Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe dhe procedurave të percaktuara në rregullat e ERE-s kur:
 - a) I Licensuari kërkon heqjen e Licensës;
 - b) I Licensuari shkel Kushtet e kësaj License përfshirë mospagesën e tarifave që kerkohen në License;
 - c) I Licensuari shkel Legjislacionin në Fuqi;
 - d) I Licensuari deklarohet i falimentuar dhe është i paafte të kryejë detyrimet sipas Kushteve të kësaj License.
 - e) I Licensuari e ka marrë Licensën me mashtrim.
 - f) Mbaron afati i Licensës; ose
 - g) Shkrihet personi që mban Licensën.
- 6.2 Nëse i Licensuari ndryshon statusin e tij ligjor ose aksionari që kontrollon interesin ndryshohet pa autorizim nga ERE, Licensa bëhet e pavlefshme dhe anulohet dhe pasuesi i të Licensuarit do të aplikojë për një licensë të re sipas procedurës së ERE-s për dhënie license.
- 6.3 I Licensuari është i detyruar të kryejë veprimtaritë e specifikuar në licensë. Nëse gjatë kryerjes së veprimtarisë së licensuar, shfaqen rrethana për shkak të të cilave i Licensuari, në mënyrë të arsyeshme nuk është në gjendje të kryejë veprimtaritë e specifikuar në Licensë, i Licensuari do

të informojë menjëherë ERE-n.

6.4 Kjo Licencë mund të transferohet vetëm me pëlqimin paraprak me shkrim të ERE-s dhe sipas afateve dhe kushteve të vendosura nga ERE. Çdo miratim nga ERE për transferimin e kësaj license do të bëhet me kusht që ERE të jetë e bindur se transferuesi do të ketë aftësinë teknike dhe financiare për të respektuar afatet dhe kushtet e kësaj license dhe se transferuesit i është dhënë një Licensë Furnizimi, dhe mund të jetë subjekt i respektimit nga transferuesi i çdo çështje tjetër të përcaktuar nga ERE si e domosdoshme. Çdo transferim i kësaj License pa miratimin e ERE-s do të jetë e pavlefshme dhe do të përbëjë një shkelje materiale të kësaj License.

6.5 Kur Licensa përfundon si pasojë e shkeljes nga i Licensuari i kushteve të Licensës, i Licensuari do të përgjigjet për kostot e vendosura mbi ERE-n, Qeverinë Shqiptare, dhe pjesëmarrësit e tregut si pasojë e këtij përfundimi, siç përcaktohet nga ERE, përfshirë kostot që lidhen me transferimin e rregullt të licensës tek një i licensuar i ri i kualifikuar.

6.6 Kur ERE përcakton se i Licensuari ka shkelur një ose më shumë kushte të Licensës, të Licensuarit do t'i jepet një mundësi e arsyeshme për të korrigjuar shkeljen para përfundimit të Licensës, përveç kur shkelja përfshin korrupsion ose pandershmeri.

7 Situatat e Emergjencës

7.1 I Licensuari nuk do të konsiderohet sikur i ka shkelur kushtet e kësaj License në rast se parandalohet në përbushjen e tyre nga forca madhore ose rrethana të tjera emergjence.

7.2 Në kushte emergjence, i Licensuari do të sigurojë bashkëpunimin e nevojshëm nga autoritetet dhe institucionet që janë përgjegjëse për veprimin në situata emergjence, me qëllim që të rifillojë furnizimi me energjinë elektrike të dëmtuar brenda periudhës kohore më të shkurtër të mundshme.

7.3 Nëse i Licensuari parashikon një situatë emergjence siç përcaktohet nga Legjislacioni në Fuqi, i Licensuari do të njoftojë ERE-n brenda 24 orëve dhe ky njoftim do të përshkruajë se çfarë hapash do të ndërmerret i Licensuari për të shmangur ose përmirësuar situatën e parashikuar të emergjencës.

8 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve dhe e Drejta për Apel

8.1 Çdo çështje e diskutueshme ose pretendim mes të Licensuarit dhe çdo klienti të Furnizuesit Publik me Shumicë ose Veprimtarie të Furnizuesit Publik me Shumicë ose Kushteve të Licensës do të zgjidhet në një mënyrë sa më miqësore, sipas Legjislacionit në Fuqi. ERE do të vendosë kushtet me tarifën, nëse janë të zbatueshme, për rishikimin e kësaj çështje.

8.2 Nëse zgjidhja nuk arrihet në mënyrë miqësore, atëherë ERE në bazë të petitionit të çdo Personi që është palë në këtë mosmarrëveshje, do ta zgjidhë mosmarrëveshjen dhe do nxjerrë vendimin e saj sipas Legjislacionit në Fuqi dhe Rregulloreve dhe Rregullave të zbatueshme të ERE-s.

8.3 I Licensuari mund ta apelojë vendimin e ERE-s në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 30 ditëve nga publikimi i vendimeve në Fletoren Zyrtare.

8.4 I Licensuari duhet t'i bindet vendimeve të ERE-s duhet te zbatoje vendimet e ERE-s ne pritje te shqyrtimit para Gjykates se Rrethit Tirane.

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Energjisë Elektrike

LICENSË
Për FURNIZIMIN PUBLIK ME ENERGJI ELEKTRIKE

Licensa i jepet:

(Emri i plotë i të Licensuarit)

Seria:

Nr. i Licensës:

Data e hyrjes në fuqi të kësaj Shtojce: _____

SHTOJCA A TERRITORI I AUTORIZUAR PËR VEPRIMTARINË E
LICENSUAR

Republika e Shqipërisë
Enti Rregullator i Energjisë Elektrike

**LICENCË
PËR
FURNIZIMIN PUBLIK ME ENERGJI ELEKTRIKE**

Licenca i jepet:

(Emri i plotë i të Licencuarit)

S

e

r

i

a

:

Nr.Li

cen

cës:

Data e hyrjes në fuqi e kësaj Shtojce: